

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën - Reporter.al
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/25/mjedisoret-dergojne-ne-kushtetuese-vendimin-qe-zhvesh-i-nga-mbrojtja-pishe-poro-narten/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 11:39:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 11:37:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	094659163b25449c00a8c77d742d69b1224390b4c6464d3a811e6e0ffc56401b
TEKSTI	3944330e63136f02fab77ec910f9579a9dd65fe908607d542221f12d849837bb
PAMJA	c8e0ba7e62940267c9cab6c7e02cc83aec3ba79cd092d784d1520b18839b04bc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0dbe631023cf9d2252a43f360d723c37d8391087116d678ba510a0336285b937
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3f529bf32420afe1b21bc6d3b8138bcb5df45885bcaf02ba5967dcac0a879fe4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0dbe631023cf9d2252a43f360d723c37d8391087116d678ba510a0336285b937>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TEMA:

BELINDA BALLUKU

ERION VELIAJ

VETING

SPAK

MJEDISI

EDI RAMA

SALI BERISHA

ZGJEDHJE 2025

Kryefaqja Lajme

Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën

Katër organizata të shoqërisë civile kanë njoftuar se do të dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese vendimarrjen e qeverisë që mundësoi, sipas tyre, ndërhyrjen në zonën e mbrojtur të Pishë Poro-Nartës dhe që po përdoret për të avancuar lejet zhvillimore në zonë.

nga Vladimir Karaj — 20 seconds më parë në Lajme Koha e leximit: 2 min lexim

AA

0



Makineri e rëndë në Pishë Poro | Foto nga : PPNEA

Katër organizata mjedisore të shoqërisë civile njoftuan të premtën se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të shfuqizuar një vendim të Këshillit të Ministrave që, sipas tyre, i hoqi mbrojtjen zonës së Pishë Poro-Nartës, duke i hapur rrugën miratimit të lejeve të zhvillimit në zonë.

Kryeministri Edi Rama dhe qeveria shqiptare nuk kanë dhënë shenja tërheqjeje nga projekti i ndërtimit të një kompleksi turistik në Zvërnec, i lidhur me Jared Kushner, dhëndrin e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump edhe pas katër muajsh protesta të përditshme në Tiranë.

Kjo i ka shtyrë organizatat EcoAlbania, Res Publica, Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS) dhe REC Albania të kërkojnë në Gjykatën Kushtetuese shfuqizimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 596, të datës 25 shtator 2024, si dhe pezullimin e zbatimit të tij deri në një vendim përfundimtar.

Organizatat thonë se ky vendim, i cili pasoi ndryshimet e vitit 2024 në ligjin "Për zonat e mbrojtura", hoqi nënzhonimin e mëparshëm për Pishë Poro-Nartën dhe uli nivelin e mbrojtjes.

"Me vendimin e vitit 2022, 42,82% e sipërfaqes së zonës ishte përcaktuar si nënzonë qendrore, ku zbatoheshin shkalla më e lartë e mbrojtjes. Në këtë territor lejoheshin vetëm kërkimi shkencor dhe veprimtaritë ekoturistike të lira në natyrë. Me VKM nr. 596/2024, sipërfaqja nën shkallën më të lartë të mbrojtjes ra nga 42,82% në zero, ndërsa ajo nën shkallën e tretë u rrit nga 2,73% në 100%", thuhet në deklaratë.

Përpara Gjykatës Kushtetuese, organizatat kundërshtojnë bazën e këtij vendimi, duke theksuar se institucionet kanë vepruar në kundërshtim me vetë gjetjet e tyre.

"Heqja e nënzonave dhe ulja e nivelit të mbrojtjes janë bërë pa një vlerësim të ri që të tregojë se vlerat natyrore të territorit janë zvogëluar," theksojnë organizatat mjedisore në deklaratën për shtyp ku njoftohet padia.

Vendimi i qeverisë lejon zhvillimin e strukturave akomoduese turistike, instalimeve energjetike, rrugëve dhe kanaleve lundruese brenda zonës. Pasojat e këtij vendimi, sipas aktivistëve, po ndihen tashmë në terren, kur kompania e lidhur me investitorët nga Katar dhe Jared Kushner, dhëndrin e presidentit të SHBA-ve, ndërhyri në zonë për punime duke hapur rreth 8 kilometra rrugë akses dhe pastruar 2,8 hektarë habitat dunor dhe pyll pishe.

Duke iu referuar katër dëmeve të dokumentuara, organizatat thonë se kjo do të provojë para Gjykatës Kushtetuese se "ndryshimet në regjimin juridik të zonave të mbrojtura mund të

Mjedisorët dërgojnë në Kushtetuese vendimin që zhveshi nga mbrojtja Pishë Poro-Nartën

13:37 | 25/09/2026

Nga aleatë të SHBA-së në të pandehur: Pse Uashingtoni e mbështeti Gjykatën Speciale për Kosovën

11:34 | 25/09/2026

Futja e Ballkanit në Shengen: një zgjidhje me përfitime për Evropën

09:59 | 25/09/2026

Zyrtarët e lartë dhe krimi i organizuar u bënë njësh në mbrojtje të Ergys Agasit

08:08 | 25/09/2026

Ish-shefja e SHISH, Vlorë Hyseni mbetet në 'arrest shtëpie'

15:39 | 24/09/2026

Avokati i Ilir Metës deklaron se rrezikon licencën nëse thyen bojkotin

14:14 | 24/09/2026

kenë pasoja konkrete mbi territore me vlera të larta natyrore.”

Kompleksi Pishë Poro-Nartë, i cili përfshin grykëderdhjen e Vjosës dhe lagunat e Nartës, është pjesë e Rrjetit Emerald dhe njihet ndërkombëtarisht si Zonë e Rëndësishme për Shpendët (IBA) dhe Zonë Kyçe e Biodiversitetit (KBA).

Organizatrat argumentojnë në padinë e tyre se “VKM nr. 596/2024 bie ndesh me standardet e mbrojtjes së natyrës të garantuara nga Kushtetuta dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria.”

Etiketa: Eco Albania Padi në Gjykatën Kushtetuese Pishë Poro -Nartë REC Albania

Res Publica Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë Zonat e Mbrojtura

Reporter.al

Opinion
Reportazhe
Analiza
Investigime
Lajme
Blog
Rajoni

Rreth nesh
Stafi
Kontaktimi
Ankesa dhe Korrigjime
Politika e privatësisë dhe rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Follow Us

X

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by [Sfida.PRO](#)